



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMLORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2024:037609

Datë: 30.05.2024

Numri i dokumentit: 05755569

C.nr.1090/2023

GJYKATA THEMLORE MITROVICË – DEGA NË SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Hajrullah Aruqi, në çështjen juridike kontestimore të paditëseve V.S. dhe A.M. nga Skenderaj, të cilat i përfaqëson Q.R. avokat në Skenderaj, kundër të paditurës Komuna Skenderaj – Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensim për inflacion dhe shujta, duke vendosur sipas marrëveshjes se palëve të arritur nga ndërmjetësuesit N.O. dhe F.O., ndërmjetësues të licencuar, bazuar në nenin 15 paragrafi 1 të Ligjit nr.06/L-009 për Ndërmjetësim dhe pas vlerësimit të marrëveshjes se palëve të arritur në ndërmjetësim, me dt.30.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

1. **APROVOHET** Marrëveshja ND.821/2024 e dt.21.03.2024 e arritur ne procedurën e ndërmjetësimit në lëndën C.nr.1090/2023.
2. Marrëveshja e arritur ne ndërmjetësim e fiton fuqinë e vendimit të formës se prerë dhe dokumentit përmbarues sipas dispozitave ligjore në fuqi përfshirë këtu edhe dispozitat e Ligjit për Procedurën Përmbarimore.
3. Vendimi iu dorëzohet palëve dhe kundër të njëjtit, sikurse edhe kundër marrëveshjes se arritur, palët nuk kanë të drejtë ankese.
4. Prishjen apo anulimin e marrëveshjes se arritur në ndërmjetësim, palët kanë të drejtë ta kërkojnë vetëm me padi të veçantë në procedurë të veçantë gjyqësore.

Gjyqtari
Hajrullah Aruqi